

MANUAL PER TE ARDHURAT VENDORE

Tiranë 2011

Ky botim u realizua nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë me ndihmën dhe mbështetjen financiare të fondacionit “Hanns Seidel”



Një falenderim i veçantë shkon për Znj. Nertila Mosko, (përfaqësuese e fondacionit “Hanns Seidel”) ekspertëve të SH.B.SH-së, Dr. Fran Brahim, MPA Jolanda Memaj dhe bashkëpunëtorëve, Znj. Frida Damnori dhe Z. Artur Kurti që ndihmuan në përgatitjen e këtij libri.



**Shoqata e Bashkive
të Shqipërisë**

Rr. Abdyl Frashëri, pall. 11, Shk 2 Ap. 14,

Tiranë,

Tel/fax ++355 4 22 57 603/6

Email: aam@albmail.com

Url: www.aam.al

Përmbajtja

1. Kuadri ligjor për taksat dhe tarifave vendore	f. 7
2. Terminologjia e taksave dhe tarifave vendore sipas kuadrit ligjor në fuqi ..	f. 9
3. Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore	f. 10
4. Të ardhura nga taksat vendore	f. 12
4.1 Taksa Vendore mbi Biznesin e vogël	f. 12
4.2 Bashkëpunimi me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit	f. 12
4.3 Përcaktimi i vendndodhjes së biznesit dhe kërkesat për regjistrim	f. 13
4.4 Niveli Tregues i Taksës së biznesit të vogël sipas ligjit	f. 13
4.5 Publikimi i nivelit të taksës	f. 14
4.6 Fillimi dhe mbyllja e biznesit	f. 14
4.6.1 Në rastin e regjistrimit fillestar	f. 14
4.6.2 Pajisja me Certifikatë Regjistrimi	f. 16
4.7 Ndërprerja e veprimtarisë së biznesit	f. 16
4.8 Llogaritja e detyrimeve për biznesin e vogël	f. 17
4.9 Pagesa e taksës vendore mbi biznesin e vogël	f. 18
4.10 Apelimi	f. 21
4.11 Kontrolli tatimor	f. 21
4.11.1 Kualifikimi si biznes i vogël	f. 22
5. Taksat mbi pronat e paluajtshme	f. 23
5.1 Taksa mbi ndërtesat	f. 23
5.2 Taksa mbi tokën bujqësore	f. 27
5.2.1 Roli i këshillave të komunave dhe bashkive	f. 29
6. Taksa e fjetjes në hotel	f. 31
7. Taksa e ndikimit të infrastrukturës	f. 31
8. Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	f. 32
9. Taksa për zënien e hapësirave publike	f. 35
10. Taksa e tabelës	f. 36
11. Taksa vendore të përkohshme	f. 36
12. Taksat e ndara	f. 37
12.1 Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	f. 37
12.2 Taksa e rentës minerare	f. 37
13. Të Ardhurave nga Tarifave Vendore	f. 38
13.1 Tarifave vendore	f. 38
13.2 Përcaktimi i nivelit të tarifës	f. 38
14. Mbledhja dhe administrimi i taksave dhe tarifave vendore	f. 39
15. Decentralizimi fiskal sfidë e së ardhmes	f. 41

Hyrje

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë (SHBSH) u themelua në 12 tetor 1993, me kërkesë të një grupi prej 10 kryetarë bashkish. Në fillim të vitit 1999 Shoqata e Bashkive Hollandeze (VNG) inicioi një projekt për të bërë te mundur ngritjen e një stafi organizativ dhe pajisjen e këtij stafi me zyra dhe me mjetet e nevojshme të punës. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në 5 Shtator të 2000 u ndryshua emri në Shoqata e Bashkive të Shqipërisë (SH.B.SH) si dhe adoptoi se bashku me emrin e ri edhe statutin e ri të Shoqatës. Përpjekjet e saj të vazhdueshme kanë synuar në sensibilizimin e strukturave dhe institucioneve të pushtetit qendror për përshtetimin e procesit të decentralizimit, si dhe konsolidimi i rolit të bashkive në ushtrim të rolit të tyre qeverisës, duke dhënë në vazhdimësi rezultate konkrete. Shoqata identifikon nevojat e anëtarëve nëpërmjet vizitave në bashki, krijimit të urave të bashkëpunimit, organizimit dhe koordinimit të një sërë aktivitetesh.

Në përmbushjen e misionit të saj, SHBSH *fokuset* në:

- a. **Evidentimin, përgjithësimin dhe mbrojtjen e interesave me karakter të përbashkët të bashkive**, në kuadër të realizimit të reformës së decentralizimit dhe autonomisë vendore.
- b. **Ofrimin e shërbimeve për bashkitë**, me synim rritjen e aftësive vendimmarrëse dhe ekzekutive të organeve dhe të administratës së bashkive, nëpërmjet trajnimeve, ekspertizës, organizimit të ëorkshopeve apo seminareve, informacioneve dhe statistikave, publikimeve, vizitave të punës brenda dhe jashtë vendit për përgjithësimin e praktikave më të mira, etj.
- c. **Lobimin** pranë organeve të pushtetit qendror, në proces të hartimit dhe zbatimit të legjislacionit për pushtetin vendor, si dhe me partnerët ndërkombëtarë, për projekte të ndryshme të zhvillimit të bashkive .

Në kuadër të programeve dhe projekteve të shumta që SH.B.SH-ja ka ndërmarrë në vite, në ndihmë të Bashkive në veçanti, një vend të rëndësishëm kanë zënë publikimet.

Duke u nisur nga veçoritë dhe nevojat specifike të bashkive janë publikuar mbi 20 libra dhe manualeve për ti ardhur në ndihmë njërive vendore si: “**Manual i Kryetarëve**”, “**Qeverisja Vendore në Shqipëri**”; “**Menaxhimi i Taksave dhe Tarifave Vendore**” “**Planifikimi Urban i Bashkive**”; “**Strategjia Kombëtare Vendore e Trajnimit**”, “**Bashkitë dhe Integrimi Evropian**”, “**Per programin 10 vjecar te bashkive per strehimin**”, “**Kryetar Unë mendoj që...**”, “**Sfidat e Vendimmarrjes dhe Këshilltari**” “**Model i rregullores dhe statutit të bashkive**” për bashkitë e vogla dhe te mesme, “ **Profili i Bashkive**”, “ **Manual për parandalimin e konfliktit të interesave në pushtetin vendor**”, “ **Aspekte të zbatimit të statusit të nëpunësit civil në pushtetin vendor**”, “**Praktikat më të mira të qeverisjes Vendore 2009**” (shqip dhe anglisht), “ **Guidë praktike mbi**

transferimin dhe menaxhimin e pronave Vendore”, “Udhëzime mbi Huamarrjen Vendore dhe Zhvillimet në të fundit në vendet e NALAS-it”etj. Shoqata shpërndan te të gjithë bashkitë dhe te të gjithë aktorët e qeverisjes vendore çdo muaj botimin **“Gazeta e Bashkive“**.

Në vazhdim të botimeve të saj, së fundi Shoqata e Bashkive ka kënaqësinë të prezantojë për njësitë vendore në Shqipëri dhe për të gjithë organizatat qeveritare dhe joqeveritare dhe të gjithë aktorët që bashkëpunojnë me pushtetit vendor, botimin e saj më të ri me titull: **“Manual për të ardhurat vendore“**

Duke shpresuar që ky manual t’ju ndihmoj sadopak në punën tuaj të përditshme,

Fatos Hodaj

Drejtor ekzekutiv i SH.B.SH-së

Pse duhet një manual për të ardhurat vendore?



Financat publike janë një problem dhe një debat i hapur kudo midis grupeve të interesit nga njëra anë dhe shtetit nga ana tjetër. Këto debate, synojnë hartimin dhe zbatimin e politikave ekonomike, sociale e fiskale sa më të përshtatshme për kushtet e vendit tonë.

Në këtë kuadër duhet parë edhe decentralizimi në përgjithësi dhe ai fiskal, në veçanti, përmes të cilit, synohet krijimi i burimeve financiare të nevojshme, për realizimin e funksioneve të qeverisjes vendore.

Reforma e decentralizimit ka bërë që shumë kompetenca dhe funksione të pushtetit qendror, të transferohen në pushtetin vendor. Ky transferim, është shoqëruar me mjetet e nevojshme financiare nga buxheti i shtetit, ose me të drejtën për të gjeneruar të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore. Aktualisht, pushteti vendor ka një autonomi substanciale në lidhje me autoritetin dhe rolin për të gjeneruar të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore. Taksat dhe tarifatat vendore, përbëjnë një burim të rëndësishëm financiar të buxhetit të pushtetit vendor dhe për këtë arsye modernizimi i këtij sektori do ishte më se i justifikueshëm. Niveli i decentralizimit në përgjithësi dhe në veçanti autonomia fiskale, u ka mundësuar njësitëve vendore të pajisen me instrumentet e duhur për hartimin e planeve afat-mesme dhe afatgjatë të programimit buxhetor dhe të zhvillimit ekonomik vendor.

Administrimi i taksave, nuk ka rëndësi vetëm në rritjen e të ardhurave dhe fondeve të disponueshme vendore, por ka rëndësi sepse ai mund të përdoret si instrument i domosdoshëm për politika fiskale vendore, instrument i cili do të inkurajonte biznesin në investime në infrastrukturë dhe që rrjedhimisht do të sillte uljen e nivelit të papunësisë dhe rritjen e nivelit të jetesës së komunitetit.

Ende në Shqipëri nuk ka një shkollë të posaçme për administrim publik dhe aq më tepër për përgatitjen e menaxherëve vendorë.

Në këto kushte, ky manual përpiqet të plotësojë, sado pak, ato boshllëqe që ekzistojnë në lidhje me mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore.

Ky manual, ka si qëllim kryesor t'u vijë në ndihmë bashkive, komunave dhe qarqeve për rritjen e performancës së mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore.

Tatimi është ajo pjesë e pasurisë të cilën çdo qytetar ia jep shtetit me qëllim që të ruajë (të ketë siguruar) pjesën tjetër të saj.

Manteskje

Tatimi është dhënie në para të cilat shteti i mbledh prej individëve në bazë të sovranitetit të vet të pakundërshtueshëm të drejtpërdrejt me qëllim të mbulimit të të dalave publike.

Gaston

Zhese

Pagimi i tatimit paraqitet si kryerje e detyrës kombëtare e cila bazohet në atë se çdo individ në kuadrin e mjeteve të veta të japë pjesën për mbulimin e shpenzimeve shoqërore.

Laufenburger

1. Kuadri ligjor për taksat dhe tarifat vendore.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit, nr. 8652, datë 30.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, u evidentua një disporporcion ndërmjet shkallës së shpenzimeve publike, përgjegjësi të shërbimit publik dhe autonomisë fiskale, e cila ishte akoma modeste. Në funksion të ngushtimit të këtyre dallimeve, në vitet e mëvonshme është rritur në mënyrë të ndjeshme niveli i autonomisë financiare.



Kalimi i taksës së biznesit të vogël plotësisht në administrimin e qeverisjes vendore, rifutja e taksës mbi tokën bujqësore si dhe dhënia e kompetencave pushteteve vendore në përcaktimin e bazës dhe nivelit të taksave, rriti në mënyrë të dukshme autonominë fiskale dhe atë financiare.

Kjo autonomi nevojshme fiskale dhe financiare, është bërë efektive nëpërmjet miratimit të një seti aktesh ligjore e nënligjore, të nevojshme.

Ky kuadër ligjor, u ka mundësuar njësi të qeverisjes vendore autonomi që të vendosin, për:

- Bazën dhe nivelin e taksave (një numër taksash të përcaktuar me ligj),
- Procedurat dhe administrimin e taksave vendore,
- Mënyrën e mbledhjes së taksave dhe zgjedhjen e agjentit tatimor,
- Lehtësimin e kategorive të ndryshme të bizneseve,
- Përfundimin e kategorive të ndryshme të komuniteteve në pagimin e taksave,
- Përdorimin e të ardhurave të grumbulluara nga taksat vendore.

Disa nga aktet e rëndësishme në fushën e taksave dhe tarifa vendore janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, (neni 157 pika 3 dhe 4 përcaktojnë të drejtën e njësi të qeverisjes vendore për të gjeneruar të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore)
- Karta Evropiane e Vet-qeverisjes Vendore (neni 9 që bëjnë fjalë për burimet financiare)
- Ligji nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”
- Ligji nr.9161, datë 18.12.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat “ i ndryshuar
- Ligji nr.9326, datë 6.12.2004 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”
- Ligji nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”
- Ligji nr. 9764, datë 09.07.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”,
- Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 1.8.2007 “Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”
- Ligji nr. 9931, datë 09.06.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”
- Ligji nr. 10073, datë 09.02.2009 Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.
- Ligji nr. 10117, datë 23.04.2009, “Për disa ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”.
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, ”Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar”.
- Ligji nr. 10146, datë 28.9.2009, “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar”.
- Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, ”Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr.10280, datë 20.5.2010, ”Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar”.
- Ligji nr. 10354, datë 18.11.2010, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.
- Ligji nr. 10457, datë 21.07.2011 Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.
- Ligji nr.10458, datë 21.7.2011, ”Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011, ”Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”
- Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm) Nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore “
- Udhëzim i Ministrisë të Financave Nr.1, datë 12.1.2007 “Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”
- Udhëzimi i Ministrisë të Financave, nr. 18, datë 23.08.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.26, datë 04.09.2008 “Për taksat kombëtare” të ndryshuar”

Sipas ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, **administrata tatimore**, përbëhet nga:

- **Administrata tatimore qendrore**, ku përfshihen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale dhe njësitë e tjera të saj;
- **Administrata tatimore vendore**, ku përfshihen zyrat tatimore nën autoritetin e qeverisjes vendore.

Administrata tatimore e qeverisjes vendore, ka të njëjtat detyra dhe të drejta, me administratën tatimore të pushtetit qendror. E gjithë procedura, e mbledhjes dhe administrimit të taksave dhe tarifave vendore, mbështetet në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, me amendimet përkatëse, si dhe në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Terminologjia e taksave dhe tarifave vendore sipas kuadrit ligjor në fuqi

Për qëllimet e këtij manuali, disa nga termat dhe përkufizimet për taksat dhe tarifave vendore, sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi, janë:

- **Autoritet fiskal** - e drejta ligjore e pushtetit vendor për të realizuar përgjegjësitë fiskale, në lidhje me taksat dhe tarifave vendore si:
 - o Të krijojë të ardhura nga taksat dhe tarifave, sipas nevojave, për realizimin e funksioneve të veta, brenda autoritetit të tij;
 - o Të kryejë shpenzime sipas nevojave, në realizimin e funksioneve të veta, brenda autoritetit të tij;
 - o Të hartojë dhe ekzekutojë një buxhet, sipas nevojave, në realizimin e funksioneve të veta, brenda autoritetit të tij, pa ndërhyrjen e qeverisë qendrore.
- **Taksë** - pagesë e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e shtetit apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që nuk bëhet në shkëmbim të mallrave dhe shërbimeve të caktuara;
- **Taksa pagues** – individ, ose enti, i cili ka detyrimin ligjor për të paguar detyrimin që rrjedh, kryesisht nga aktiviteti, ose të drejtat e pronësisë së individit, apo entit.
- **Niveli i taksës** - një përqindje fikse mbi bazën e taksës e vendosur me ligj, ose me vendim të organit të njësisë së qeverisjes vendore.
- **Administrata e taksave** - institucioni që aplikon dhe verifikon zbatimin e ligjit, vendos modalitetet e pagesës dhe mbledhjes së tatimeve dhe taksave vendore, informon këshillin e njësisë së qeverisjes vendore dhe mban llogaritë.
- **Takse vendore** – ajo lloj takse (sipas kuptimit të përcaktuar mësipërm) e cila përmbush dy kushte:
 - o Pushteti vendor ka disa shkalle lirie për të vendosur mbi nivelin e saj, si detyrim ligjor.
 - o Pushteti vendor merr 100 përqind të shumës që mblidhet prej saj.
- **Takse kombëtare**- një takse për të cilën gjithçka vendoset në nivelin e qeverisjes qendrore.



- **Taksa te ndara (share tax)** - ato taksa kombëtare, një pjesë e të ardhurave të të cilave i kalojnë pushtetit vendor, me ligj. Administratori i kësaj takse, derdh për llogari të pushtetit vendor përqindjen e përcaktuar sipas ligjit, por vetëm pasi kjo, të jetë paguar nga taksapaguesi. Pushteti vendor, është i lirë ta përdore këtë shume për nevojat e veta.
- **Tarifë** - pagesa që individi, apo një ent i caktuar bën përkundrejt një përfitimit/përdorimit të një malli/shërbimi publik.
- **Agjent tatimor** – personi fizik, ose juridik, që mbledh dhe transferon në buxhetin e shtetit/vendor tatimet, taksat ose tarifat.
- **Kontribut** - detyrimi monetar për t'u paguar si shpërblim, për një shërbim specifik apo ushtrim të të drejtave, për sigurimin shoqëror dhe shëndetësor të të punësuarve.
- **Libra dhe regjistrime** - regjistrimet tregtare, dokumentacioni kontabël, llogaritë vjetore dhe raportet financiare, si dhe të gjitha dokumentet e tjera, që kanë të bëjnë me subjektin tatimpagues, korrespondencën e biznesit, faturat dhe dokumentet përkatëse, të cilat duhen krijuar dhe mbajtur për përcaktimin e shumave të tatimeve, që duhen paguar nga tatimpaguesi.
- **Përfaqësues i tatimpaguesit** - personi i autorizuar ligjërisht, për të përfaqësuar tatimpaguesin në çështje tatimore.
- **Tatimpagues** – personi/individi, i cili detyrohet nga ligji të paguajë tatime, taksa ose kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe agjenti i mbajtjes së tatimit në burim.
- **Vend kryesor i biznesit** - vendi i administrimit efektiv të biznesit.
- **Person i lidhur me tatimpaguesin**, sipas rastit, janë:
 - o personat, me të cilët është/janë lidhur një/shumë marrëveshje biznesi;
 - o kontrolluesi apo i kontrolluari prej tij;
 - o individët, që kanë lidhje gjaku deri në shkallën e dytë në rastin e individit tregtar;
 - o individët, që ushtrojnë detyra drejtuese në organizimin e më shumë se një tregtari;
 - o individët, që kanë marrëdhënie punësimi edhe me tatimpagues të tjerë.

3. Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore

Të ardhurat e veta, të bashkive/komunave, krijohen kryesisht nga taksat dhe tarifat vendore, për të cilat njësitë vendore kanë autoritet të plotë ligjor, për të vendosur nivelin e taksës mbi atë orientues, ose tregues i cili përcaktohet me ligj.

Modalitetet për ndryshimin e nivelit të taksës, përcaktimin e mënyrës së mbledhjes etj., janë të përcaktuara në ligjin nr. 9632,

datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” me amendimet përkatëse dhe në



ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe të shpjeguara më poshtë në këtë manual.

Për mbledhjen e të ardhurave të veta tatimore dhe jo-tatimore, njësitë vendore duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë:

- a. Llogaritjen e të ardhurave, duke u bazuar në njësinë bazë të masës, ose masën/nivelin ligjor orientues në vartësi të llojit të aktivitetit që taksohet. Tregues të tillë mund të jenë sipërfaqja e tokës, sipërfaqja e ndërtimit të një ndërtesë, xhiro vjetore e realizuar, çmim/njësi, vlera mesatare e shitjes së ndërtesave dhe vlera e çdo lloji prone tjetër, etj.
- b. Njësinë e vlerësimit, e cila për taksat është quajtur baza e taksës, e cila shërben për vlerësimin e të ardhurave nga një taksë e caktuar. Ky tregues, shprehet në vlera për çdo njësi treguese, si p.sh. xx lekë / ha, ose xx lekë/m², etj.
- c. Normën e llogaritjes ose nivelin e taksës. Ky tregues, përfaqëson shumën e të ardhurave/taksave për njësinë llogaritjeje të taksimit. Ai, shprehet në shumë/vlerë absolute, ose në përqindje për çdo njësi. Për vendosjen e normës, ose nivelit të taksës, mbi bazën e taksës, kompetencë kjo e njësite vendore, merren parasysh disa faktorë, të cilët kryesisht mund të përmbliken në:
 - Ndryshimet në bazën e taksës gjatë periudhës 3-5 vitet e fundit;
 - Inflacioni.
 - Rritja ekonomike dhe politikat e njësisë në mbështetje të biznesit.
 - Përqindja e mbledhjes së taksës/tarifës të paktën gjate vitit të fundit.



Departamenti i Taksave dhe i Financës/Buxhetit, pranë bashkisë/komunës, bën planifikimin analitik të të ardhurave të veta. Ky proces, kërkon një vlerësim paraprak dhe të dhëna të detajuara nga zyrat e tjera të cilat janë të ngarkuara me mbledhjen e të dhënave dhe administrimin e aktiviteteve që krijojnë të ardhurat e bashkisë/ komunës.

• **Të ardhurat nga taksat vendore, përfshijnë të ardhurat nga:**

- a. taksa vendore mbi biznesin e vogël;
- b. taksa mbi pasuritë e paluajtshme:
 - taksa mbi ndërtesat dhe
 - taksa mbi tokën bujqësore;
- c. taksa e fjetjes në hotel;
- ç. taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
- d. taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
- dh. taksa për zënien e hapësirave publike;
- e. taksa e tabeles;
- ë. taksa të përkohshme;
- f. taksat e ndara

- ✓ taksa vjetore e mjeteve të përdorura
- ✓ taksa e rentës minerare

• **Të ardhurat nga tarifat vendore, përfshijnë të ardhurat nga:**

- a. Nga tarifat e shërbimeve të ndryshme publike,
- b. Nga gjobat dhe të tjera të hyra.



4. Të ardhurat nga taksat vendore

4.1 Taksa Vendore mbi Biznesin e vogël

Taksa vendore mbi biznesin e vogël, zbatohet nga çdo subjekt, kur e ardhura bruto vjetore (qarkullim) gjatë vitit fiskal, është më e vogël ose e barabartë me 8.000.000 (tetë milionë) lekë.

Taksa Vendore mbi Biznesin e Vogël, mblihdet dhe administrohet nga zyra e taksave të njësjive të qeverisjes vendore (të bashkive/komunave).

Për tu ardhur në ndihmë njësjive të qeverisjes vendore në identifikimin e subjekteve të taksueshme, është bere një ndarje bizneseve në grupe.

Kështu, biznesi i vogël ndahet:

- a. Në grupin “*shitje me pakice*” - përfshihen të gjitha pikat fikse (dyqanet, njësitë, barakat, etj.) që tregtojnë mallra/furnizojnë shërbime për konsumatorin përfundimtar.
- b. Në grupin “*shitje me shumicë*” - përfshihen të gjitha pikat fikse (magazina, dyqane, etj) që realizojnë shitje që bëhen për tatimpagues të tjerë, për konsum prodhues, ose rishitje të mallrave. Në rast se njësia realizon njëkohësisht shitje të mallrave me shumicë e pakicë, ajo do të klasifikohet në grupin “shitje me shumicë”
- c. Në grupin “*prodhim*” - përfshihen tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari prodhimi, përpunimi dhe tregtimi.
- d. Në grupin “*shërbime*” - përfshihen tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari shërbimi, tilla si: riparimi i artikujve elektro-shtëpiakë, radio-televizorë, frigoriferë, lavatriçe, magnetofon, pajisje fonie e të tjera të ngjashme me to.
- e. Në grupin “*profesione te lira*” - përfshihen tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtarinë e avokatit, noterit, mjekut, mjekut-laborant, stomatologut, farmacistit, ekonomistit kontabël të miratuar, ekspertit kontabël të autorizuar, mësuesit, veterinerit, agronomit, botuesit, inxhinierit, arkitektit, projektuesit, e profesione të tjera të lira të cilat ushtrohen në njësi fikse apo në ambiente të ndryshme, etj të ngjashme me këto.



4.2 Bashkëpunimi me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit (QKR)

Nëpunësit e sporteleve të shërbimit të QR-së në bashki e komuna, janë nëpunës të njësjive të qeverisjes vendore përkatëse, të cilët varen edhe nga strukturat qendrore të QKR-së. Në këtë kuptim kjo detyrë/kompetence, është e deleguar nga pushteti qendror në atë vendor. Sipas ligjit për QKR-në, njësitë e qeverisjes vendore, nëse e gjykojnë të arsyeshme, mund të hapin zyra, apo sportele të QR-së, në njësitë e tyre,



ardhurat vendore

por gjithnjë faturën financiare të menaxhimit të saj, duhet ta përballojnë vet. QKR-ja bashkëpunon dhe shkëmben informacion me:

- Autoritetet tatimore qendrore/ të bashkive/ komunave, për lehtësimin e informacionit lidhur me regjistrimin fiskal.
- Institucionet e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore.
- Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Institutin e Statistikave.

QKR-ja, nëpërmjet sporteleve të shërbimit, njofton në mënyrë elektronike bashkitë/komunat, që janë të lidhura në rrjet, të dhënat mbi subjektet tatimore, si: selinë apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, të gjitha të dhënat e regjistrimit të deklaruara në formularin përkatës dhe të dhënat e detyrueshme, sipas dispozitave, që rregullojnë fushën tatimore, kurse në njq-v-të, që nuk janë të lidhura në rrjet, QKR-ja i dërgon këto të dhëna me postë.

4.3 Përcaktimi i vendndodhjes së biznesit dhe kërkesat për regjistrim

Tatimpaguesit i kërkohet të paguajë taksën vendore mbi biznesin e vogël, për çdo vendndodhje biznesi, në përputhje me nivelin tatimor të përcaktuar për llojin e biznesit dhe kategorinë e zonës gjeografike, ku ai është regjistruar.

Një “**Vendndodhje biznesi**” është një zonë e dallueshme dhe e ndarë, si në të njëjtën godinë, ashtu edhe në godina të ndryshme.

Shëmbull:

- Kur veprimtari të ndryshme ekonomike, kryhen nga një tatimpagues, në të njëjtën dhomë, konsiderohen si **një** “vendndodhje biznesi”.
- E njëjta veprimtari ekonomike e kryer nga një tatimpagues, në dy dhoma që kanë komunikim nga brenda, konsiderohen një biznes, pra konsiderohen si **një** “vendndodhje biznesi”.
- Dy veprimtari të ndryshme ekonomike, të kryera nga një tatimpagues, në dy dhoma që kanë komunikim nga brenda, konsiderohen dy biznese, pra konsiderohen si **dy** “vendndodhje biznesi”.
- Disa veprimtari ekonomike, të ndryshme ose e njëjta veprimtari ekonomike e kryer në dy dhoma fqinje, që nuk komunikojnë me njëra tjetrën nga brenda, konsiderohen si **dy** “vendndodhje biznesi”.

Tatimpaguesi është i detyruar të paguajë taksën vendore mbi biznesin e vogël për çdo vendndodhje biznesi sipas nivelit tatimor në fuqi në kohën e regjistrimit.

4.4 Niveli tregues i taksës së biznesit të vogël

Nivelet treguese të taksës vendore mbi biznesin e vogël, të dhëna në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar”, janë orientuese. Shuma faktike e tatimit për t’u paguar, për çdo kategori biznesi, përcaktohet nga këshilli i bashkisë/komunës në të cilën ndodhet biznesi. Këshilli i

bashkisë/komunës, mund të ndryshojë nivelin orientues të taksës, të përcaktuar në aneksin 5, në nivelet + 10 për qind / - 30 për qind.

Taksat dhe tarifat e tjera, që aplikohen mbi biznesin e vogël, sipas ligjit nr. 10117, datë 23.4.2009, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar”, nuk duhet të jenë më shumë se 10 për qind e nivelit tregues të taksës së biznesit të vogël, sipas kategorisë së rrethit dhe qarkullimit vjetor përkatës.”.



4.5 Publikimi i nivelit të taksës

Këshilli i bashkisë/komunës, për çdo vit kalendarik, duhet të informojë taksapaguesit e juridiksionit të tij, për nivelet e taksave që do të zbatohen, jo më vonë se data 15 dhjetor e vitit pararendës, duke i botuar ato në gazetata e mediat lokale dhe duke vendosur afishe në ndërtesa e vende publike.

Nëse bashkia/komuna, nuk e bën një gjë të tillë, taksapaguesit, janë të detyruar të zbatojnë nivelet orientuese të taksës të përcaktuara në Aneksin 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar”.



4.6 Fillimi dhe mbyllja e biznesit

4.6.1 Në rastin e regjistrimit fillestar

Kur një tatimpagues, regjistrohet për herë të parë, ai, duhet të paraqesë pranë QKR-së, dokumentet dhe të dhënat e mëposhtme:

1. Kërkesën për regjistrim, ku të jepet saktë emri dhe adresa e tatimpaguesit, adresa e vendndodhjes së biznesit, si dhe tipi i biznesit, që do të kryhet në atë “vendndodhje biznesi”.
2. Dokumentin e identifikimit (çertifikatë personale me fotografi, ID, pasaportë). Regjistrimi tregtar, fillestar, i subjekteve tregtare, bëhet vetëm një herë dhe bëhet pranë zyrave të QKR-së. Ai (regjistrimi fillestar), është unik dhe vlen për regjistrimin tregtar, regjistrimin tek autoritetet tatimore qendrore dhe ato vendore, si dhe vlen gjithashtu si regjistrim për efekt të sigurimeve shoqërore, për inspektimin e punës, edhe për qëllime statistikore, etj.

Subjektet, për tu regjistruar, përveç të dhënave tregtare duhet të deklarojnë të dhënat e detyrueshme, sipas legjislacionit tatimor (të dhënat fiskale).

QKR-ja, bën regjistrimin fillestar dhe lëshon çertifikatën e regjistrimit. Të dhënat tregtare, sipas ligjit janë

- Për person fizik të dhënat e identifikimit, emri, vendndodhja/et e ushtrimit të aktivitetit/veprimtarisë, objekti, etj;
- Për një Shpk: emri, forma, data e themelimit, themeluesit, objekti, afati, administrimi, etj.



Të dhënat fiskale, sipas ligjit janë:

- Xhiro vjetore e deklaruar
- Lloji i aktivitetit (Kodi NACE)

Në rast se subjekti i regjistruar, ushtron veprimtarinë në më shumë se një vend, QKR-ja, lëshon nga një çertifikatë regjistrimi për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë.

Bazuar në ligjin 19920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” ndryshuar me Ligjin nr.10415, datë 7.04.2011. “Përditësimi i të dhënave të regjistrimit”

1. Tatimpaguesi, person fizik dhe juridik, regjistron çdo ndryshim të të dhënave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, siç përcaktohet në ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.
2. Tatimpaguesi, statusi i të cilit ndryshon nga një kategori në tjetrën, sipas parashikimeve në ligjet e veçanta tatimore, duhet të njoftojë administratën tatimore përkatëse, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të ndryshimit. Kur një ndryshim i tillë i statusit diktohet nga një kontroll, i kryer nga administrata tatimore, qendrore ose vendore, administrata që kryen kontrollin njofton administratën tjetër, brenda 10 ditëve kalendarike pas këtij ndryshimi.
3. Organizatat jofitimprurëse duhet të njoftojnë administratën tatimore për ndryshimet që vijnë, brenda 15 ditëve nga data e regjistrimit të ndryshimeve:
 - a) ndryshimi i emrit;
 - b) ndryshimi i adresës së veprimtarisë ose kontaktit;
 - c) ndryshimi i statusit ligjor;
 - d) krijimi/mbyllja e degëve, sektorëve ose njësive të reja;
 - e) ndryshimi i llojit të veprimtarisë ekonomike;
 - f) ndryshimi i numrit të punonjësve;
 - g) çdo ndryshim tjetër, i parashikuar në aktet nënligjore, të dala në zbatim të këtij ligji.

4.6.2 Pajisja me Çertifikatë Regjistrimi.

QKR-ja, pasi verifikon saktësinë e dokumenteve dhe të dhënave të mësipërme të paraqitura nga tatimpaguesi, e regjistronjë atë.

Çertifikata e regjistrimit:

- **Përmban emrin e tatimpaguesit, numrin e regjistrimit që i është caktuar atij, numrin e vendimit të gjykatës, adresën e vendndodhjes së biznesit me të cilin lidhet dhe datën e lëshimit.**
- **Është e detyrueshme të vendoset në një hapësirë të dukshme të vendndodhjes së biznesit, me qëllim identifikimin e regjistrimit të kësaj vendndodhje.**
- **Është subjekt inspektimi nga zyra e taksave në bashki apo në komunë dhe nga dega e Tatimeve nën juridiksionin e së cilës është bashkia apo komuna përkatëse.**

Tatimpaguesit që kryejnë biznese në më shumë se një vendndodhje, të cilat nuk janë brenda së njëjtës bashkie/ komunë, pajisen me Çertifikatë regjistrimi nga QKR-ja për çdo “vendndodhje biznesi”.

Sipas ligjit 9920 date 19,05,2008 “Për procedurat tatimore” ndryshuar me ligjin nr.10415, datë 7.04.2011, “Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pajisur”.

- a) Kur administrata tatimore identifikon persona, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomik- tregtare pa u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, atyre u mbyllet veprimtaria dhe u konfiskohen të gjitha materialet, sipas nenit 121 të këtij ligji.
- b) Në rast se një person ushtron veprimtari në fushën e shërbimeve, i pajisur me leje/licencë/autorizim profesional, por nuk e ka regjistruar veprimtarinë në QKR, përveç konfiskimit të materialeve, administrata tatimore u propozon strukturave kompetente pezullimin e lejes/licencave/autorizimeve për ushtrim veprimtarie për një periudhë gjashtëmuajor.

4.7 Ndërprerja e veprimtarisë së biznesit

Nëse tatimpaguesi mbyll aktivitetin, ai duhet të paraqesë një kërkesë në QKR për çregjistrim. Subjektet e regjistruara pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit çregjistrohen pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore të papaguara dhe pasi të kenë paraqitur bilancin e mbylljes, subjektet, sipas legjislacionit në fuqi.

QKR-ja, njofton organin tatimor kompetent për regjistrimin e hapjes së procedurave të likuidimit apo për kërkesën për çregjistrim të personit fizik. Organi tatimor vendor, brenda 30 ditëve nga data e këtij njoftimi, është i detyruar të verifikojë situatën tatimore dhe, kur është e nevojshme, të ushtrojë kontroll në mjedisin, ku ushtron veprimtarinë subjekti.



QKR-ja, nuk mund të kryejë çregjistrimin, në qoftë se, brenda 30 ditëve, administrata tatimore vendore e kundërshton, me shkrim çregjistrimin. Kundërshtimi i çregjistrimit të tatimpaguesit nga administrata tatimore vendore tregon shumën e detyrimeve tatimore të papaguara të tatimpaguesit.

Nëse pas 30 ditëve nga data e njoftimit, organi tatimor vendor nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim me shkrim, apo kundërshtimi nuk përmban shumën e detyrimeve tatimore, të gjobave dhe interesave të papaguara, QKR-ja kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit.

Nëse, brenda 30 ditëve, tatimpaguesi shlyen detyrimin tatimor vendor, administrata tatimore vendore e tërheq kundërshtimin menjëherë dhe QKR-ja e çregjistron tatimpaguesin brenda 5 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të tërheqjes së kundërshtimit nga administrata tatimore, ose pasi tatimpaguesi paraqet një dokument, që vërteton pagesën e të gjitha detyrimeve tatimore.

Nëse pavarësisht shlyerjes, organi tatimor vendor nuk ka tërhequr kundërshtimin, atëherë subjekti mund t'i paraqesë QKR-së dokumentin, që vërteton shlyerjen e shumës totale të detyrimeve tatimore, të gjobave dhe interesave të përcaktuara në kundërshtimin për çregjistrim. Në këtë rast QKR-ja, kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit dhe njofton organin tatimor kompetent.

Çregjistrimi tatimor nuk eliminon detyrimet ekzistuese tatimore dhe nuk parandalon administratën tatimore të vlerësojë ose të mbledhë detyrimet tatimore, pas revokimit të regjistrimit.

Administrata tatimore vendore, kur zotëron prova se tatimpaguesi, për një periudhë tatimore për 12 muaj të njëpasnjëshëm deklaron pezullim veprimtarie tregtare, transferon regjistrimin e një tatimpaguesi nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv, që mbahet nga administrata tatimore vendore.

Transferimi i regjistrimit tatimor nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv nuk eliminon detyrimin tatimor ekzistues dhe nuk e ndalon administratën tatimore për vlerësimin ose mbledhjen e detyrimit tatimor, pas transferimit në regjistrin pasiv.

Ndryshimet e **fushës së veprimtarisë së tatimpaguesve**, subjekte të këtij ligji, deklarohen pranë bashkisë/komunës, brenda territorit të së cilës ushtrojnë veprimtarinë. Ministri i Financave, në bashkëpunim me ministrin që mbulon çështjet e pushtetit vendor, përcakton me udhëzim procedurat për deklarimin e këtyre ndryshimeve.

4.8 Llogaritja e detyrimeve për biznesin e vogël

Detyrimi vjetor për taksën vendore mbi biznesin e vogël, përcaktohet nga zyra e taksave në bashki/komunë vetëm mbi bazën e qarkullimit të parashikuar për t'u realizuar gjatë vitit nga tatimpaguesi. Për këtë tatimpaguesi është i detyruar të paraqesë, brenda datës 1 mars të çdo viti, deklaratën parashikuese të qarkullimit. Përcaktimi i detyrimit bëhet duke pasur parasysh qarkullimin e parashikuar në deklaratën




parashikuese të qarkullimit, llojin e aktivitetit, kategorinë e biznesit dhe niveli tregues të taksës sipas aneksit 5 te ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar”. Shuma e detyrimit vjetor të përcaktuar si më sipër ndahet në tremujorë. Brenda datës 15 mars të çdo viti, zyrat e taksave në bashki/komunë, i dërgojnë zyrtarisht çdo tatimpaguesi të juridiksionit njoftimin e detyrimit tatimor vjetor, të ndarë në tremujorë.

Për tatimpaguesit që brenda datës 1 mars nuk paraqesin deklaratën parashikuese të qarkullimit vjetor, përcaktimi i detyrimit tatimor bëhet sipas gjykimit më të mirë të vetë zyrës së taksave në bashki dhe në komunë. Si më sipër veprohet edhe për tatimpaguesit e paregjistruar që regjistrohen nga zyra. Njoftimi i detyrimit në këtë rast i dërgohet tatimpaguesit brenda 15 ditëve nga momenti i regjistrimit nga zyra.

4.9 Paguesa e taksës vendore mbi biznesin e vogël

Pagesat e taksës vendore mbi biznesin e vogël bëhen sipas kësteve të përcaktuara nga zyra e taksave në bashki/komunë. Taksa paguhet në çdo degë banke dhe në çdo zyrë postare prezente në territorin e bashkisë apo të komunës, ose në arkën e vetë bashkisë/komunës përkatëse. Paguesa e detyrimeve, bëhet brenda datës së përcaktuar në ligj, si më poshtë:

- për 3-mujorin e parë brenda datës 20 të muajit prill,
- për 3- mujorin e dytë brenda datës 20 korrik,
- për 3-mujorin e tretë brenda datës 20 tetor dhe
- për 3-mujorin e katërt brenda datës 20 janar.



LLOGARITJET PËR DETYRIMIN E TAKSAVE TË BIZNESIT TË VOGËL

Nr	Emërtimi i taksës/tarifës	Baza e taksës	Niveli i taksës lekë	Niveli i taksës Lekë	Niveli i taksës Lekë
			Kategori I	Kategori II	Kategori III
1	Tregti me pakicë	Xhiro deri në 2 milion	45,000	25,000	23,000
2	Tregti me shumicë	Xhiro deri në 2 milion	45,000	25,000	23,000
3	Prodhimi	Xhiro deri në 2 milion	33,000	23,000	20,000
4	Shërbime	Xhiro deri në 2 milion	25,000	20,000	20,000
5	Profesionistë të pavarur	Xhiro deri në 2 milion	38,000	30,000	22,000
6	Tregtarë ambulante	Xhiro deri në 2 milion	8,000	5,000	5,000
7	Tregti me pakicë	Xhiro deri në 2-3 milion	68,000	48,000	45,000
8	Tregti me shumicë	Xhiro deri në 2-3 milion	68,000	48,000	45,000
9	Prodhimi	Xhiro deri në 2-3 milion	55,000	45,000	43,000
10	Shërbime	Xhiro deri në 2-3 milion	48,000	43,000	43,000

1 1	Profesionistë të pavarur	Xhiro deri në 2-3 milion	60,000	53,000	45,000
1 2	Tregti me pakicë	Xhiro deri në 3-4 milion	83,000	63,000	60,000
1 3	Tregti me shumicë	Xhiro deri në 3-4 milion	83,000	63,000	60,000
1 4	Prodhimi	Xhiro deri në 3-4 milion	70,000	60,000	48,000
1 5	Shërbime	Xhiro deri në 3-4 milion	63,000	58,000	58,000
1 6	Profesionistë të pavarur	Xhiro deri në 3-4 milion	75,000	68,000	60,000
1 7	Tregti me pakicë	Xhiro deri në 4-5 milion	98,000	78,000	75,000
1 8	Tregti me shumicë	Xhiro deri në 4-5 milion	98,000	78,000	75,000
1 9	Prodhimi	Xhiro deri në 4-5 milion	85,000	75,000	73,000
2 0	Shërbime	Xhiro deri në 4-5 milion	78,000	73,000	73,000
2 1	Profesionistë të pavarur	Xhiro deri në 4-5 milion	90,00	83,000	75,000
2 2	Tregti me pakicë	Xhiro deri në 5-6 milion	113,00 0	93,000	90,000
2 3	Tregti me shumicë	Xhiro deri në 5-6 milion	113,00 0	93,000	90,000
2 4	Prodhimi	Xhiro deri në 5-6 milion	100,00 0	90,000	88,000
2 5	Shërbime	Xhiro deri në 5-6 milion	93,000	88,000	88,000
2 6	Profesionistë të pavarur	Xhiro deri në 5-6 milion	105,00 0	98,000	90,000
2 7	Tregti me pakicë	Xhiro deri në 6-7 milion	128,00 0	108,00 0	105,000
2 8	Tregti me shumicë	Xhiro deri në 6-7 milion	128,00 0	108,00 0	105,000
2 9	Prodhimi	Xhiro deri në 6-7 milion	115,00 0	105,00 0	103,000
3 0	Shërbime	Xhiro deri në 6-7 milion	108,00 0	103,00 0	103,000
3 3	Profesionistë të	Xhiro deri në 6-7 milion	120,00	110,00	105,000

1	pavarur		0	0	
3 2	Tregti me pakicë	Xhiro deri në 7-8 milion	143,00 0	123,00 0	120,000
3 3	Tregti me shumicë	Xhiro deri në 7-8 milion	143,00 0	123,00 0	120,000
3 4	Prodhimi	Xhiro deri në 7-8 milion	130,00 0	120,00 0	118,000
3 5	Shërbime	Xhiro deri në 7-8 milion	123,00 0	118,00 0	118,000
3 6	Profesionistë të pavarur	Xhiro deri në 7-8 milion	135,00 0	128,00 0	120,000
	Transporti i pasagjerëve				
3 7	Automjete me deri në 5 vende	Numri i automjeteve	17,500		
3 8	Automjete me 6 - 9 vende	Numri i automjeteve	35,000		
3 9	Automjete me 10 - 25 vende	Numri i automjeteve	40,000		
4 0	Automjete me 26 - 42 vende	Numri i automjeteve	45,000		
4 1	Automjete me mbi 42 vende	Numri i automjeteve	48,000		
	Transporti i mallrave				
4 2	Automjete deri në 2 ton	Numri i automjeteve	28,000		
4 3	Automjete 2,1 - 5 ton	Numri i automjeteve	40,000		
4 4	Automjete 5,1 - 10 ton	Numri i automjeteve	48,000		
4 5	Automjete 10,1 - 16 ton	Numri i automjeteve	50,000		
4 6	Automjete mbi 16 ton	Numri i automjeteve	75,000		
	Transporti ujqor				
4 7	Transport ujqor brenda vendit	Numri i trageteve	55,000		
4 8	Transport ujqor liqenor	Numri i transportit liqenor	48,000		
4 9	Anije shplohëse biznesi	Numri i anijeve të biznesit	15,000		

Klasifikimi:

Në kategorinë I: Bashkitë: Tirane dhe Durrës.

Në kategorinë II: Bashkitë: Shkodër, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Elbasan, Fier, Lushnje, Pogradec, Berat, Lezhë dhe Kavajë.

Në kategorinë III: Të gjitha bashkitë e tjera.

Në komuna niveli tregues i taksës është 50 për qind e nivelit tregues të tij për çdo kategori të rrethit në të cilin ndodhet komuna.

Shënim:

Ambulantë konsiderohen vetëm bizneset pa vend fiks që kanë qarkullim jo më të madh se 2 milionë lekë në vit. Nëse vlerësohet se qarkullimi është më i madh ato klasifikohen në një nga kategoritë e tjera të biznesit dhe taksohen sipas asaj kategorie. Ambulantet nuk regjistrohen në QKR, por ata detyrimisht duhet të jenë të regjistruar në njësinë vendore ku e ushtrojnë aktivitetin.

4.10 Apelimi

Çdo tatimpagues që nuk bie dakord me një vlerësim tatimor të zyrës së taksave në bashki apo në komunë, si dhe me çdo veprim tjetër të saj, ka të drejtë të apelojë te kryetari i bashkisë apo i komunës përkatëse, brenda 30 ditëve nga data e vlerësimit tatimor apo nga data e çdo veprimi tjetër të zyrës së taksave. Apelimi bëhet me shkrim dhe ai përmban:

- a. Emrin, adresën dhe NIPT-in e apeluesit;
- b. Vitin tatimor, me të cilin lidhet apelimi;
- c. Natyrën dhe shumën e tatimit ose gjobës që është subjekt apelimi;
- d. Baza ku mbështetet apelimi.

Procedurat e apelimit dhe procedurat e shqyrtimit të apelimit tatimor, bazohen në përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.24, datë 2.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Nëse tatimpaguesi nuk është dakord me vendimin e kryetarit të bashkisë apo të komunës përkatëse, ai ka të drejtë të apelojë në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e këtij vendimi.

4.11 Kontrolli tatimor

Gjatë vitit, zyra e taksave në bashki/komunë kontrollon rregullshmërinë e regjistrimeve të kërkuara nga ligji për tatimpaguesit. Për këtë qëllim ato kontrollojnë:

- lëshimin e kuponit tatimor, të dëftesës tatimore apo faturës së thjeshtë,
- regjistrimin e çdonjërit prej këtyre dokumenteve në librin e qarkullimit.

Ato kontrollojnë gjithashtu edhe evidentimin dhe regjistrimin nga tatimpaguesi të blerjeve të realizuara për qëllimet e biznesit (rishiçe, përpunim apo shpenzime të tjera), nëpërmjet dokumentacionit përkatës.

Zyra e taksave në bashki apo në komunë, gjithashtu, mund të ushtrojë kontroll të plotë në ambientet e tatimpaguesit, duke e njoftuar paraprakisht atë. Në kontrollin e plotë organi tatimor kontrollon dhe verifikon mbajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe regjistrimeve sipas përcaktimeve ligjore.

Krahas kontrollit të dokumentacionit, zyrat e taksave mund të bëjnë kontrolle (sondazhe për matjen e xhiros) për çdo tatimpagues, me qëllim vlerësimin e qarkullimit të realizuar nga tatimpaguesi nëpërmjet kronometrimit.

Kur vlerësohen detyrime tatimore shtesë, zyrat e taksave në bashki apo në komunë mund të përdorin metoda alternative vlerësimi të parashikuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimin në zbatim të tij.

Këto metoda përdoren në rastet kur zyrat e taksave konstatojnë së dokumentacioni i blerjeve dhe shitjeve nuk është mbajtur konform kërkesave ligjore, që do të thotë se: tatimpaguesi nuk pasqyron në mënyrë korrekte qarkullimin, nuk lëshon në mënyrë korrekte dokumentin e kërkuar për çdo shitje, nuk pasqyron në librat e blerjes të gjitha furnizimet që ka kryer. Gjithashtu, këto metoda do të përdoren edhe në rastet kur tatimpaguesit nuk deklarojnë qarkullimin e realizuar. Këto metoda do të përfshijnë, por pa u kufizuar vetëm në to, sondazhet dhe fotografimet e kryera lidhur me xhiron, sipërfaqet e prodhimit apo të shërbimit që disponon tatimpaguesi, pozicioni i vendit të biznesit (qendër apo periferi), detyrimet e llogaritura nga tatimpagues të rregullt, por që kanë afërsisht të njëjtat kushte biznesi sikurse tatimpaguesi të cilit i bëhet vlerësimi, konsumi i energjisë elektrike, niveli i qirasë, numri i punonjësve etj.

4.11.1 Kualifikimi si biznes i vogël

Tatimpaguesit e taksës vendore mbi biznesin e vogël, të cilët në bazë të deklaratës parashikuese të qarkullimit apo në bazë të vlerësimeve të bëra nga zyra e taksave në bashki apo në komunë, rezultojnë me një volum qarkullimi (xhiro) më të madh se 8 milionë lekë në vit kalendarik, janë tatimpagues që duhet të administrohen nga degët përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave. Zyrat e taksave në bashki apo në komunë, brenda 5 ditëve-punë nga momenti i konstatimit se qarkullimi i tatimpaguesit është mbi 8 milionë lekë, janë të detyruara të njoftojnë me shkrim menjëherë degën përkatëse të Tatimeve, si dhe të dërgojnë dosjen e plotë të tatimpaguesit. Që nga ky moment (data e njoftimit me shkrim) tatimpaguesi dhe dosja e tij administrohet nga dega përkatëse e Tatimeve. Dega e Tatimeve nga ana e saj njofton zyrtarisht tatimpaguesin për këtë fakt dhe ndërmerr të gjitha veprimet e duhura për regjistrimin dhe aktivizimin e tatimpaguesit si detyrues për llojet e tjera të detyrimeve tatimore.

5. Taksat mbi pronat e paluajtshme

Taksa mbi ndërtesën dhe taksa mbi tokën bujqësore, përfaqësojnë dy taksat vendore mbi pronat e paluajtshme. Këto taksa aplikohen mbi të gjithë individët ose subjektet fizike e juridike, të cilët janë pronarë të një ndërtese dhe/ose të një sipërfaqe toke, e klasifikuar kjo si tokë bujqësore. Planifikimi, llogaritja dhe mbledhja e këtyre taksave rregullohet sipas përcaktimeve në ligjin 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

5.1 Taksa mbi ndërtesat

Baza e taksës mbi ndërtesat është “sipërfaqja e ndërtimit në metër katror” e ndërtesës, ose pjesës së saj mbi dhe, në nivelin e tokës dhe për çdo kat.

Në zbatim të pikës 1 të nenit 22 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar” sipërfaqe ndërtimi do të konsiderohet çdo sipërfaqe pavarësisht nga pozicioni vertikal (poshtë apo lart) në raport me truallin mbi të cilin është ndërtuar.

Nuk konsiderohen sipërfaqe ndërtimi shkallët dhe sheshet e tyre, ndarjet dhe modifikimet e ndryshme brenda kufirit të dy sipërfaqeve të ndërtimit që përbëjnë katet e ndërtesave, kur ndërtesat janë në pronësi të përbashkët.

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave, zyrat e taksave të bashkisë/komunës njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të cilat, sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar”, u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive/komunave për pasuritë e paluajtshme, të regjistruara pranë tyre.

Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë/komunës, për vërtetim pronësie njohin:

- Vendimet e pronësisë
- Vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave të paluajtshme
- Vendimet e privatizimit
- Dokumente të tjera të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës.

Organet e pushtetit vendor ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor.

Në rastet e mungesës të dokumentacionit të vërtetimit të



pronësisë sa më sipër për shkaqe objektive, zyrat e taksave të bashkive/komunave, për përcaktimin e bazës së taksueshme sigurojnë të dhëna nëpërmjet vetdeklarimit. Këto të dhëna do të përdoren në mënyrë të përkohshme, deri në regjistrimin e pronës nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme apo verifikimit të pronës nga komisionet e verifikimit të pasurive.

Në mungesë të të dhënave sa më sipër Këshilli i komunës/bashkisë, përcakton kritere për vlerësimin e sipërfaqes së taksueshme, për efekt të përcaktimit të masës së detyrimit.

Sipas ligjit nr.9764, datë 09.07.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”,

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen edhe taksapaguesit, të cilët kanë, në përdorim apo në pronësi, ndërtesa Brenda territoreve të miratuara si fshatra turistike. Sipërfaqja e ndërtesës, në përdorim apo pronësi, përcaktohet në bazë të dokumenteve, që vërtetojnë përdorimin ose pronësinë e saj.

Këshillat e komunave dhe bashkive, përcaktojnë taksën mbi ndërtesat për çdo individ, person fizik, juridik, vendas dhe të huaj në bazë të sipërfaqes së ndërtimit të përcaktuar në planimetrinë, ose projektin e ndërtesës përkatëse.

Taksapagues të taksës mbi ndërtesat, janë të gjithë individët, personat fizik, juridik vendas dhe të huaj, që kanë në pronësi ndërtesa.

Përfshirjet

Sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar”, përfshihen nga taksa mbi ndërtesat

- Pronat e shtetit dhe të njëjstëve të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse.
- Ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qiramarrësit me qira të paliberalizuar.
- Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare.

Në bazë të nenit 6 të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar”, subjektet e parashikuara me ligje të veçanta, përfshihen nga taksat e drejtpërdrejta. Për këtë, të gjithë invalidët e punës, veteranët e luftës kundër pushtesve nazifashistë të popullit shqiptar, të verbrit, invalidët paraplegjike dhe tetraplegjike duhet detyrimisht të paraqesin pranë autoriteteve të pushtetit vendor dëshmitë e statusit përkatëse (që e fitojnë në bazë të ligjit nr 7874, datë 17.11.1994, “Për Statusin e Veteranit të Luftës kundër pushtesit nazifashist të popullit shqiptar”, i ndryshuar, ligjit nr 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”, dhe ligjit nr. 7889, date 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”). Këshilli i komunës, apo bashkisë vendos për lehtësimin, ose përfshirjen nga taksa të personave nën minimumin jetik, bazuar në kriteret kombëtare të vlerësimit të këtij minimumi, si dhe personave që ju dëmtohet pasuria nga forca madhore në përputhje me ligjin.

Kategoritë minimale të ndërtesave të dhëna në aneksin nr. 1 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar”, mund të nënkategorizohen nga këshillat e bashkive/komunave.



Këshillat e bashkive dhe komunave kanë të drejtë të miratojnë nivelin e taksës mbi ndërtesat +/- 30 për qind, te nivelit tregues të kësaj takse sipas aneksit nr. 1 të ligjit.

Ndërsa për tatimpaguesit e biznesit të vogël kufijtë janë + 10/- 30 për qind”. Sipas pikës d) nënpika ii) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar”, Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, vendos nëse mbledhja e kësaj takse do bëhet nga strukturat e njq-v-të, ose nga të tretët (agjent të mbledhjes së taksave).

Njqv-të njoftojnë individët, personat fizik dhe juridik vendas ose të huaj për detyrimin e taksës mbi ndërtesat. Taksapaguesi njoftohet nëpërmjet një formulari për shumën për t’u paguar, datën e duhur, vendin e pagesës dhe numrin e kodit buxhetor të bashkisë/komunës.

Për çdo rast të ndryshimeve të mundshme të sipërfaqeve të ndërtimit nga individët, personat fizik e juridik, vendas a të huaj, ata duhet të njoftojnë njq-v-të nëpërmjet një deklarate e cila do të shoqërohet me planimetrinë dhe projektin përkatës.

NIVELET TREGUESE TË TAKSËS MBI NDËRTESET

	Bashkitë		
	Zona 1	Zona 2	Zona 3
Kategoritë minimale të ndërtesave	Tiranë Durrës	Vlorë Fier Sarandë Pogradec Korçë Elbasan Berat Lushnjë Gjirokastrë Shkodër Kavajë Lezhë	Të gjitha bashkitë e tjera
Lekë/m ² në vit			
I. Ndërtesa banimi			
- ndërtuar para 1993-shit	15	10	5
- ndërtuar gjatë dhe pas 1993-	30	12	6

shit			
II. Ndërtesa të tjera			
- për tregti dhe shërbime	200	150	100
- të tjera	50	30	20
III. Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike	200	200	200

Shënim:

- I. Nivelet treguese të taksës, dhënë në tabelë, janë të vlefshme për ndërtesat në zonat urbane (bashkitë), si dhe për ndërtesat në të gjithë zonat (urbane dhe rurale) të seksionit III të tabelës “Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike”.
- II. Në zonat rurale (komunat), niveli tregues i taksës për çdo kategori minimale të ndërtesës (përfshijtur seksionin III) është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës të kategorisë minimale të ndërtesës në bashkitë qendër rrethi, në cilat ndodhet komuna.

Sipas nenit 1 të ligjit nr. 10146, datë 28.9.2009, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2007, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar”: “Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk bëjnë regjistrimin apo çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme, ndërtesë apo tokë bujqësore, nëse dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e bashkisë apo komunës, i cili konfirmon pagesën e taksave respektive”.

Shembull:

Planifikimi i taksës mbi ndërtesat

Këshilli i Bashkisë që ndodhet në zonën e dytë, ka marre vendim që taksën mbi ndërtesat e banimit ndërtuar para vitit 1993, ta aplikojë 90 % të nivelit tregues të aneksit nr. 1 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2007 “Për sistemin e taksave vendore” dhe ato të ndërtuara pas vitit 1993, të shtoj 5 % të nivelit të aneksit nr. 1 të ligjit, për tregti dhe shërbime të shtoj 6% të nivelit tregues të aneksit të ligjit. Bashkia ka 80% të banesave të ndërtuara para vitit 1993.

Nr	Ndërtesat sipas funksionit	Sipërfaqe ne m2	Norma e taksës ne lekë/m2	Shuma e taksës ne
----	----------------------------	-----------------	---------------------------	-------------------

				000/Lek
I.	Ndërtesa banimi			3,888
1	Ndërtuar para vitit 1993	320 000	(10x90/100) 9	2,880
2	Ndërtuar gjatë dhe pas vitit 1993	80 000	(12x105/100) 12.6	1,008
II	Ndërtesa të tjera			18,302
1	Për tregti dhe shërbime	113,220	(150x106/100) 159	18,002
2	Të tjera.	10,000	30	300
TOTAL (I – II)				22,190

5.2 Taksa mbi tokën bujqësore

Në bazë të nenit 23, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar”, baza e taksës, është sipërfaqja e tokës bujqësore në hektar, në pronësi të tatimpaguesit.

Dokumentet bazë, për përcaktimin e sipërfaqes së tokës bujqësore, janë:

- Për zonat ku ka përfunduar procesi i regjistrimit është “Çertifikata e regjistrimit”;
- Për zonat që nuk ka përfunduar procesi i regjistrimit, dokumenti provizor bazë është, “Akti i marrjes së tokës në pronësi” (Tapia e firmosur nga pronari i tokës);
- Për zonat që nuk ka kaluar toka në pronësi, dokumenti provizor bazë, është “Akti i marrjes së tokës në përdorim”
- Vendimi i komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës
- Vendimet e privatizimit
- Dokumente të tjerë të lëshuar nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me ligjin.

Seksionet e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark, ju vënë në dispozicion komunave/bashkive, regjistrat dhe hartat kadastrale për tokën bujqësore, dokumentet e pronësisë së tokës bujqësore, vendndodhjen (pozicionin, kufijtë, koordinatat, madhësinë, pjerrësinë, etj., si dhe tregues të tjerë që disponojnë këto seksione. Në rastet kur ZRPP dhe Seksionet e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, nuk disponojnë harta pranë institucioneve të tyre, ngarkohet Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë Krujë (Departamenti i Tokës dhe Ujit) për riprodhimin e tyre (sipas tarifave të përcaktuara). Në këto raste kërkesa behet nga njësia e qeverisjes vendore.

Pjelloria e tokës sipas klasave, përcaktohet mbi bazën e bonitetit të ngastrave të tokave. Te dhënat ekzistuese për këtë tregues duhet t'ia dërgojë bashkisë/komunës Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nëpërmjet Drejtorive Rajonale në qarqe dhe Sektorët e Bujqësisë të këtyre Drejtorive në qytetet (rrethet) jo qendër qarku. Gjithashtu, ZRPP në rrethe, Drejtoritë e Bujqësisë në qarqe dhe Sektorët e Bujqësisë te këtyre Drejtorive në qytetet (Rrethet) jo qendër Qarku, Seksionet e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qarqe, vënë në dispozicion të bashkisë/komunës gjithë dokumentacionin që disponojnë për taksën e tokës bujqësore.

Në rastet kur mungon boniteti, ngarkohet Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë Krujë, Drejtoritë e Bujqësisë në qarqe dhe Sektorët e Bujqësisë të këtyre Drejtorive në qytetet (rrethet) jo qendër qarku, Seksionet e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qarqe, për të përcaktuar bonitetin e tokës, mbi bazën e të dhënave ekzistuese, ose mbi baza krahasuese. Në këto raste, kërkesa bëhet nga njësia e qeverisjes vendore, ku konstatohet ky problem. Njqv-ja ja bën kërkesën Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, e cila nga ana e saj brenda 15 ditëve, duhet ta marrë atë në konsideratë.

Ndryshimi:

- i kategorive të tokave pyjore, kullotave dhe pyjeve në toka bujqësore,
- i kategorisë nga tokë e pafrytshme, në tokë bujqësore dhe
- i kategorisë nga tokë bujqësore në toke të pafrytshme, në livadhe, kullote, tokë pyjore dhe pyll

bëhet me propozimin e Këshillit të komunës/bashkisë dhe miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Ndryshimi i kategorisë së tokave bujqësore në tokë truall (tokë urbane) bëhet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” dhe ndryshimeve të mëvonshme të këtij ligji.

Taksapagues i taksës mbi tokën bujqësore, është çdo individ, person fizik, juridik vendas dhe i huaj qe ka në pronësi tokë bujqësore.

Përfundimet

Në bazë të nenit 6, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ”Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar”, subjektet e parashikuara me ligje të veçanta, përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta. Në përputhje me këtë nen, nga taksa e tokës bujqësore përjashtohen invalidët e punës. Sipas pikës 3 të nenit 23, të ligjit të sipërcituar, nga taksa e tokës bujqësore përjashtohen për 5 vite nga momenti i mbjelljes:

- a. Tokat bujqësore që mbillen me kultura drufutrore,
- b. Tokat bujqësore që mbillen me vreshtari.

Këshilli i komunës/bashkisë, vendos për lehtësimin, ose përjashtimin nga taksa, të personave nën minimumin jetik, bazuar në kriteret kombëtare të vlerësimit të këtij minimumi.

5.2.1 Roli i këshillave të komunave/bashkive

Këshillat e bashkive/komunave, kanë të drejtë të miratojnë nivelin e taksës mbi tokën bujqësore +/- 30 për qind të nivelit tregues të kësaj takse të dhënë në Aneksin nr. 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006,” Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar”. Mbështetur në vendimin e marrë nga këshilli i komunës ose bashkisë për nivelin e taksës mbi tokën bujqësore, zyrat përkatëse bëjnë përllogaritjet e këtij detyrimi për personat fizik dhe juridik vendas dhe të huaj. Në përllogaritje duhet marrë parasysh niveli i taksës dhe sipërfaqja e tokës.

Tokat bujqësore, që shtrihen në territorin e më shumë se një njq-v-je, pavarësisht nga vendbanimi i pronarit, secila njësi trajton pjesën e pronës brenda territorit të vet, si pronë më vete.

Këshilli i komunës/bashkisë, ka kompetencë të vendos kushte lehtësuese, në rastet e pagesës së plotë dhe para afateve, të detyrimeve nga tatimpaguesi.

Tatimpaguesi, njoftohet, nëpërmjet akt-detyrimit, për shumën për t’u paguar, datën e duhur, vendin e pagesës dhe numrin e kodit buxhetor të bashkisë/komunës. Njqv-ja, vendos mbi mënyrën e njoftimit. Lajmërimi, duhet të bëhet zyrtarisht, në media elektronike, të shkruara dhe vizive, si dhe të afishohet në qendrat e komunave/bashkive, ose në lagje.

KATEGORIT MINIMALE DHE TREGUESE TE TAKSES MBI TOKEN BUJQESORE

Klasifikimi sipas rretheve			
1	2	3	4
Tiranë	Shkodër	Gjirokastrë	Bulqizë
Durrës	Elbasan	Përmet	Has
Kavajë	Berat	Pogradec	Kukës
Krujë	Korçë	Librazhd	Tropojë
Lezhë	Delvinë	Dibër	Pukë
Lushnjë	Kurbin	Mat	Mirditë
Fier	Peqin	Skrapar	Malësi e
Vlorë	Kuçovë	Mallakastër	Madhe
Sarandë		Devoll	Gramsh
		Tepelenë	Ersekë

VLERA E TAKSES NE LEK/HA

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës	1	2	3	4
I	5 600	4 200	2 800	1 400
II	4 900	3 500	2 100	1 200

III	4 200	2 800	1 400	1 100
IV	3 600	2 300	1 350	1 000
V	3 000	1 900	1 250	900
VI	2 400	1 600	1 200	800
VII-X	1 800	1 400	1 100	700

Shënim:

Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Sipas nenit 1 të ligjit nr. 10146, datë 28.9.2009, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2007, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar” *“Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk bëjnë regjistrimin apo çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme, ndërtesë apo tokë bujqësore, nëse dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e bashkisë apo komunës, i cili konfirmon pagesën e taksave respektive”.*

Shembull:

Llogaritja e detyrimeve për taksën e tokës bujqësore.

Personi fizik “X” në fshatin Gur i Zi të komunës Guri i Zi të Qarkut Shkodër ka përfituar tokë bujqësore në bazë të formularit Nr. 6 (ose tapisë) 1.5 ha. Këshilli i komunës Gur i Zi ka vendosur që niveli i taksës mbi tokën bujqësore të jetë +10 % të nivelit tregues të dhëne në aneksin Nr. 2 të ligjit Nr. 9632 datë 30/10/2006. Sipas aneksit Nr. 2 të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 rrethi Shkodër klasifikohet në zonën e dytë.

Përlllogaritjet bëhen si me poshtë:

Nr	Emërtimi i parcelës	Sipërfaqja në ha	Klasifik. sipas bonitetit	Klasifik. sipas rrethit	Niveli tregues i taksës në lekë	Vend.Kesh +10% rritje	Vlera në leke
1	2	3	4	5	6	7(6x110%)	8(7x3)
1	Parcel.20	0.5	1	2	4200	4620	2310
2	Parcel.29	0.5	2	2	3500	3850	1925
3	Parcel.39	0.5	5	2	1900	2090	1045
	Shuma	1.5					5280

Taksa mbi token bujqësore për vitin 2010 e personit fizik “X” nga fshati Gur i Zi i Komunës Gur i Zi, Rrethi Shkodër është 5,280 lekë.

Për afatet e pagesës së taksapaguesit vendos këshilli i njësisë së qeverisjes vendore.

6. Taksa e fjetjes ne hotel

Sipas nenit 26 të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar”, me hotel, do të kuptohet: “*Çdo veprimtari që jep strehim, kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër, që përdoret për këtë qëllim*”.

Baza e taksës së fjetjes, në hotel, është çmimi i fjetjes për dhomë ose për person në një natë. Kjo taksë është për fjetjet në hotel si të personave me shtetësi shqiptare ashtu dhe për personat me shtetësi të huaj.

Sipas ligjit, Këshilli i komunës/bashkisë, vendos për nivelin e kësaj takse, deri në 5 për qind të çmimit të fjetjes. Gjithashtu, këshilli miraton kategori dhe nënkategori për klasifikimin e hoteleve. Bashkia/komuna, në fillim të çdo viti fiskal, njofton të gjithë personat fizik, ose juridik që ushtrojnë aktivitetin e hotelerisë, për kategorinë e hotelit (sipas klasifikimit të bërë nga Këshilli) dhe nivelin e taksës së fjetjes, në hotel.

Detyrimi për këtë taksë i takon klientit që strehohet në hotel dhe ky detyrim mbahet nga hoteli për llogari të njqj-së në territorin e të cilit ndodhet hoteli. Në librin e hotelit dhe në faturën e klientit, shënohet kjo taksë, si e veçantë.

Derdhja e kësaj takse, bëhet çdo datë 5, të muajit pasardhës. Në fund të çdo muaji, bëhet një akt-rakordim midis pronarit të hotelit, ose të autorizuarit të tij dhe përfaqësuesit të njqj-së.

Regjistri i fjetjes në hotel, duhet të sekretohet dhe të vuloset nga bashkia/komuna, ku ndodhet hoteli.

7. Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Sipas nenit 27 të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar”, baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri. Për efekt të përlllogaritjes së kësaj takse, shërben preventivi i investimit.

Niveli i taksës shprehet në përqindje ndaj vlerës së investimit. Niveli i taksës është:

- Për bashkinë e Tiranës 2-4 për qind të vlerës së investimit.
- Për bashkitë e tjera dhe komunat: 1-3 për qind të vlerës së investimit.

Këshilli i bashkisë/komunës, ka të drejtë që brenda këtyre kufijve, të miratojë nivelin e kësaj takse, si dhe kategoritë dhe nënkategoritë, për klasifikimin e investimeve të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të taksës.

Njqj-ja, ka të drejtë të kryejë kontrolle, për saktësinë midis preventivit dhe situacionit, për efekt të llogaritjes së kësaj takse. Për çdo rast të konstatimit të diferencave, njqj-ja ndjek procedurat ligjore për arkëtimin e tyre.



Detyrimi për taksën i takon investitorit dhe të ardhurat nga kjo taksë mbliidhen nga organi që lëshon lejen e ndërtimit, për llogari të njq-v-së, ku përfshihet territori në të cilin bëhet investimi.

Në rast se objekti në të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një njq-v-je, të ardhurat, ndahen në mënyre proporcionale ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës njësi.

Këshillat e bashkive/komunave kanë të drejtë të miratojnë procedura shtesë për administrimin e kësaj takse. Sipas nenit 2 ligjit nr. 10146, datë 28.9.2009, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2007, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar”: *“Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit”*.

Sipas ligji nr.10073, datë 09.02.2009 Për disa ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar

8. Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

- Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat, është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Kategoritë e ndërtesave, për efekt të bazës së taksueshme, jepen në aneksin nr.3 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
- Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme, është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind.

Vjelja e taksës së kalimit të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, bëhet nga ZRPP. Të ardhurat nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, ndahen:

- ZRPP në rolin e agjentit të mbledhjes së kësaj takse përfitojnë, 3 për qind të shumës së mbledhur,
- Njqv-të, në të cilin ndodhet pasuria përfitojnë 97 % të shumës së mbledhur.

Të ardhurat e njq-v-së, që i takojnë sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, derdhen për llogari të buxhetit të tyre, jo më vonë se data 30 e çdo muaji. Kjo taksë, paguhet nga personat fizik dhe juridik, që kalojnë të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, një personi tjetër.

Për shembull një shoqëri ndërtimi që ndërton apartamente banimi, apo objekte të tjera me destinacion prodhimin apo shërbimet, kur të bëj kalimin e së drejtës së pronësisë për sipërfaqet respektive, personave të tjerë (të cilët mund të jenë persona

fizike, persona juridike, apo individë) duhet të paguajë taksën sipas masës së përcaktuar në aneksin nr. 3 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006. ZRPP nuk do të regjistrojnë kalimin e pasurisë së paluajtshme, pa u kryer më parë pagesa e taksës.

Në rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë së ndërtesave, kur bashkë me të është edhe sipërfaqja e truallit poshtë ndërtesës, taksa paguhet vetëm për sipërfaqen e ndërtesës.

Ne rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë nga personat fizik, sipas nenit 29 pika 1.b të ligjit nr. 9632, datë 12.12.2002, ZRPP duhet të kërkojnë nga personi, plotësimin e një deklaratë, me anë të së cilës të deklarohet nën përgjegjësinë personale, që ai nuk ushtron veprimtari si person fizik në fushën e ndërtimit, apo transferimit të pasurive të paluajtshme. Organet tatimore vendore, kontrollojnë rast pas rasti vërtetësinë e këtyre deklaratave.

ZRPP, mbajnë si dokument justifikues të pagesës së taksës, mandatin origjinal të pagesës, e cila vërteton pagesën e bërë për llogari të njqV-së përkatëse.

ZRPP, mbajnë një regjistër të veçantë për pagesat, ku evidentohen:

- emri i personit që kalon të drejtën e pronësisë,
- emri i personit të cilit i kalohet e drejta e pronësisë,
- sipërfaqja,
- vlefëta e shitjes (në rastin e shitjes) së pasurisë së paluajtshme,
- deklaratat e personave fizikë dhe shuma e taksës së paguar.

Këto regjistrime janë objekt i kontrollit nga organet tatimore vendore.

Përfshihen nga pagimi i kësaj takse:

a. Individët, të cilët kalojnë të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme dhe paguajnë për këtë kalim tatimin mbi të ardhurat personale, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 8438, datë 28.1.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar”.

b. Enti Kombëtar i Banesave, për të gjitha sipërfaqet e shitura prej tij. Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe organet e qeverisjes qendrore dhe vendore.

c. Subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme, kur përfitues të drejtpërdrejte janë:

- Institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore dhe vendore;
- Bashkësitë fetare, ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre, pa qëllim fitimin. Në këto raste, dhuruesi bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak/komunal, për përjashtimin nga taksa. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi, i paguan pjesën që i takon, agjentit të taksës.

Për rastet kur pranohet nga vet palët, ose vërtetohet ligjërisht simulimi i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohet taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjit.

Niveli i taksës së kalimit të pronësisë mbi ndërtesat, jepet në aneksin nr. 3 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ku përcaktohen kategoritë e ndërtesave, bashkitë të

ndara ne tre zona dhe niveli i taksës leke/m². Komunat, zbatojnë nivelin e taksës për zonën e 3-të të bashkive.

Detyrimi për tu paguar, llogaritet nga ZRPP e rrethit ku bëhet regjistrimi i pasurisë dhe derdhet në llogarinë e njëq-së në territorin e së cilës ndodhet pasuria. Agjenti tatimor (ZRPP), përcaktuar në pika 4 të nenit 28 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, është i detyruar të derdh në buxhetin e njëq-së, taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë, për pasurinë e paluajtshme, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës. Jashtë këtij afati, për agjentin tatimor zbatohen sanksionet e parashikuara në legjisllacionin fiskal.

NIVELET E TAKSËS SË KALIMIT TË PRONËSISË MBI NDËRTESAT

	Bashkitë		
	Zona 1	Zona 2	Zona 3
Kategoritë e ndërtesave	Tiranë Durrës	Vlorë Fier Sarandë Pogradec Korçë Elbasan Berat Lushnjë Gjirokastrë Shkodër Kavajë Lezhë	Të gjitha bashkitë e tjera
Lekë/m ²			
I. Ndërtesa banimi	1 000	300	100
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	2 000	700	300
II. Ndërtesa të tjera	1 500	500	200

Shënim

- I. Nivelet treguese të taksës, dhënë në tabelë, janë të vlefshme për bashkitë.
- II. Të gjitha komunat zbatojnë nivelin e taksës për zonën 3 të bashkive.

9. Taksa për zënien e hapësirave publike

Baza e taksës për zënie të hapësirave publike, shprehet në metër katror sipërfaqe publike, të zënë. Sipërfaqja e zënë mund të jetë horizontale dhe vertikale.

Njqv-të, bëjnë vjeljen e kësaj takse, mbi bazën e sipërfaqes së territorit të zënë në tregjet e lejuara, kundrejt biletës, që i dorëzohet personit (subjektit), që është lejuar nga për kryerjen e veprimtarive të tij, në atë sipërfaqe tregu. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesve.

Niveli tregues i taksës për zënien e hapësirave publike jepen në aneksin nr. 6 të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006, klasifikuar sipas kategorisë së rrethit ku njqv-ja bën pjese. Këshillat e njqv-ve, vendosin për ndryshimin e këtij niveli në masën +/-30 për qind, nga niveli tregues i përcaktuar në aneksin nr. 6 të ligjit të sipërcituar.

Të ardhurat nga taksa e zënies së hapësirës publike, arkëtohen në bankë, ose në arkën e njqv-së.

NIVELI TREGUES I TAKSES SE ZENIES SE HAPESIRES PUBLIKE

Bashkitë		
Zona 1	Zona 2	Zona 3
Tiranë Durrës	Vlorë Fier Sarandë Pogradec Korçë Elbasan Berat Lushnjë Gjirokastër Shkodër Kavajë Lezhë	Të gjitha bashkitë e tjera
Lekë/m² në muaj		
120	90	60

Shënim:

Për komunat, niveli tregues i taksës për çdo zonë të treguar në tabelë është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës në bashkitë qendër rrethi, në të cilat ndodhet komuna.

10. Taksa e tabelës

Baza e taksës së tabelës, mund të jetë sipërfaqja e saj, ose tabela e standardizuar, ku si bazë shërben numri i tyre.

KATEGORITË E BAZËS SË TAKSËS SË TABELËS DHE NIVELI I TYRE

Kategoritë	Niveli i taksës
1) Tabelë për qëllime identifikimi: a) Tabelë për qëllime identifikimi, pavarësisht nga sipërfaqja, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. b) Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim.	120 lekë/vit 120 lekë/vit
2) Tabelë për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike: a) Për Bashkinë e Tiranës b) Për bashkitë qendër qarku c) Për bashkitë e tjera dhe komunat	<ul style="list-style-type: none">• 45 000 lekë/m²/vit deri në sipërfaqen 18 m².• Për sipërfaqe më të mëdha se 18 m² paguhet 810 000 lekë/vit.• 22 500 lekë/m²/vit deri në sipërfaqen 18 m².• Për sipërfaqe më të mëdha se 18 m² paguhet 405 000 lekë/vit.• 13 500 lekë/m²/vit deri në sipërfaqen 18 m².• Për sipërfaqe më të mëdha se 18 m² paguhet 243 000 lekë/vit.
3) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.	1000 lekë/m ² /ditë

11. Taksa vendore të përkohshme

Këshilli i njq-v-së, kur e gjykon të domosdoshme, vendos taksa me karakter të përkohshëm, në interes të përgjithshëm të komunitetit, në territorin brenda

juridiksionit të tij. Masa e taksave me karakter të përkohshëm, së bashku me taksat dhe tarifatat e aplikueshme, nuk duhet të kalojnë kufirin + 10 për qind, të nivelit tregues të taksës së biznesit të vogël, sipas tabelës së taksimit të subjekteve të këtij biznesi.

12. Taksat e ndara

12.1 Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është taksë e ndarë (*share tax*) me buxhetin qendror. Vjelja e kësaj takse kryhet nga Drejtoritë Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat, janë agjent tatimor i mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbledhin këtë taksë dhe e derdhin brenda datës 30 të çdo muaji për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njërive të qeverisjes vendore, të taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit.

DRSHTRR, si agjent tatimor mbajnë një komision prej 5 për qind të totalit mujor të të ardhurave dhe nga vlera e mbetur, 18 për qind e derdhin pranë degës së thesarit të rrethit ku është njëzia e qeverisjes vendore dhe 82 për qind, e derdhin për llogari të buxhetit qendror.

Rakordimi i pagesës së taksës midis strukturave të DRSHTRR dhe organeve tatimore të administratës vendore, kryhet në bazë të Regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar sipas Udhëzimit nr. 18, datë 23.08.2011, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.26, datë 04.09.2008 "Për taksat kombëtare" të ndryshuar", të Ministrit të Financave.

12.2 Taksa e rentës minerare

Taksa e rentës minerare është taksë e ndarë (*share tax*) me buxhetin qendror. Vjelja e kësaj takse kryhet nga Drejtoritë rajonale të Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale të Doganave sipas procedurave të përcaktuara nga ligji nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar"

Drejtoritë rajonale të Tatimeve dhe Doganave janë agjent tatimor i mbledhjes së taksës së rentës minerare dhe e derdhin atë në buxhetin e shtetit. Gjithashtu ato raportojnë periodikisht pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me vlerën e arkëtuar të taksës së rentës minerare si dhe të njërive të qeverisjes vendore në të cilat kryhet aktiviteti minerar nga subjekti tatimpagues i rentës minerare.

Ministria e Financave, në bazë të informacionit periodik nga këto institucione, sipas procedurave të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Financave, alokon për çdo



njësi të qeverisjes vendore pjesën e rentës që i takon në bazë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

13. Të Ardhurave nga Tarifat Vendore

Për të hartuar një program të ardhurash, për tarifat vendore, është e rëndësishme të dihet se sa të ardhura do të mbledh njq-v-ja, nga arkëtimi i të gjitha tarifave të shërbimeve dhe mallrave publike, që ofron, në mënyre analitike. Përgjithësisht, kur llogarisim të ardhurat nga tarifat vendore, duhet të marrim në konsideratë të ardhurat e mbledhura të vitit paraardhës, duke evidentuar pengesat dhe faktorët subjektiv, që kanë ndikuar në mosmaksimizimin e mbledhjes së këtyre të ardhurave. Mbledhja e të ardhurave nga tarifat vendore, duhet të synojë në mbulimin e kostove të ofrimit të këtyre shërbimeve/mallrave publike.

13.1 Tarifat vendore

Tarifat e shërbimit, zakonisht shprehin një marrëdhënie kontraktuale midis siguruesit të shërbimit dhe klientit. Ato në përgjithësi, nuk janë pagesa të detyrueshme (por, në raste të veçanta, mund të lidhen me pagesa të detyrueshme). Masa e këtyre pagesave lidhet, ose mbulon koston e dhënies së një shërbimi/ malli specifik.

Baza e tarifës, varet nga natyra e shërbimit dhe e të mirës publike, që një njësi vendore ofron.

Tarifa:

Është pagesa që një person fizik, apo juridik, i bën një niveli qeverisës, apo enti publik që varet apo është kontraktuar nga njësi vendore, në shkëmbim të:

- Një shërbimi specifik të marrë.
- Një të mirë publike të përdorur.
- Një të drejtë të dhënë nga vet njq-v-ja.

13.2 Përcaktimi i nivelit të tarifës

Në përgjithësi, niveli i tarifës, duhet të reflektojë koston e shërbimit/mallit të furnizuar, të së mirës publike të përdorur, apo lejes së dhënë.

Kjo kosto duhet përcaktuar drejt, pasi:

- Nëse tarifa do të caktohej poshtë nivelit, të ardhurat do të ishin të pamjaftueshme dhe nuk do të mbulonin shpenzimet.
- Nëse tarifa do të caktohej mbi nivelin e koston, konsumatori i shërbimit do të trajtohej në mënyre të padrejtë, duke rrezikuar pagesën e tarifës.

Tarifat, në disa raste, mund të caktohen mbi, ose nën nivelin e koston, p.sh kur kosto reale, është e lartë, atëherë tarifat mund të caktohen më të ulta se kosto dhe diferenca mbulohet nga subvencione të vet njq-v-së, ose nga buxheti i shtetit, në varësi të politikave fiskale.

Mbledhja e këtyre tarifave, bëhet nga siguruesi i shërbimit, por mbledhja e tarifave mund të kryhet edhe nga një ent i pavarur nga dhënësi i shërbimit, i cili kontraktohet në rolin e agjentit.

Sipas nenit 5 te ligjit nr.10117, datë 23.04.2009, *“Tarifat, vendosen dhe administrohen, në përputhje me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendor. Këshilli i njq-v-së, vendos për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcaktojnë nëse tarifat do të mblihdhen nga vetë strukturat bashkiake/komunale, apo nga një agjent, por në asnjë rast shuma e tarifave vendore, të aplikueshme për tatimpaguesit e biznesit të vogël, nuk duhet të kalojë 10 për qind të nivelit tregues të taksës, sipas tabelës së taksimit të subjekteve të biznesit të vogël”*.

Pushteti vendor, është përgjegjës për ofrimin e një sërë shërbimesh, të cilat mund të shfaqin karakteristika të ndryshme, si p.sh, ato mund të jenë me natyrë publike, me natyrë private, por që zotërojnë pak, ose aspak karakteristika publike.

Objektivi i një njqv-je, duhet të jetë ai që, të gjitha familjet, bizneset, apo institucionet që mund të paguajnë, duhet të paguajnë tarifat e shërbimeve që jepen nga një njësi vendore. Rritja e të ardhurave nga tarifat e shërbimeve, veçanërisht pastrimi dhe furnizimi me ujë, kërkon përmirësimin e metodave aktuale dhe angazhimin e të gjithë aktoreve. Kjo gjë, mund të kërkojë që njqv-të, të marrin masa të tilla, si:

- Procedura më të mira faturimi.
- Hapjen e shumë pikave ku mund të bëhet pagesa.
- Aplikimin e metodave më efikase për llogaritjen e sasive të shërbimeve.
- Përmirësimin e metodave të mbledhjes së tarifave.
- Caktimin e një, ose disa agjenteve, për të ndjekur çështjet e bizneseve, ose familjeve që nuk paguajnë.

14. Mbledhja dhe administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Hapat për mbledhjen dhe administrimin e taksave dhe tarifave vendore, janë përcaktuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *“Për sistemin e taksave vendore”*, i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, Udhëzimin e përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm) nr. 655/1, datë 06.02.2007 *“Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”*, Udhëzimin e Ministrisë të Financave, nr. 1, datë 12.1.2007 *“Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”*, Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 24, datë 02.09.2008, *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, etj.

Kjo metodologji, përcakton plotësisht, veprimet dhe hapat, që janë ndërmarrë nga qeverisja vendore, për një administrim sa më eficient të taksave dhe tarifave.

Megjithatë, në praktikë, vihet re që ka paqartësi dhe mangësi në zbatimin e metodologjisë së mbledhjes së taksave dhe tarifave. Për këtë arsye, po shtjellojmë me poshtë një përmbledhje të hapave dhe pikave kryesore të mbledhjes dhe administrimit të taksave dhe tarifave vendore.

I gjithë kuadri ligjor për sistemin e taksave, në Republikën e Shqipërisë, përkohet nga fryma e unifikimit dhe e bashkëpunimit e të gjitha niveleve të qeverisjes dhe e agjencive që operojnë në drejtim të mbledhjes së parave publike, për nevoja korrente dhe investime.

Në këtë kontekst, procedurat tatimore janë të njëjta si për administratën vendore ashtu edhe atë qendrore dhe për rrjedhojë bashkëpunimi midis tyre, duhet të jetë i natyrshëm.

Sipas ligjit për QKR-në, bashkëpunimi me pushtetin vendor, fokusohet në:

- Evidentimin e bizneseve të paregjistruara dhe detyrimin e tyre për tu regjistruar;
- Dhënie e informacionit periodik nga QKR-ja, pushtetit vendor, në lidhje me regjistrimin dhe çregjistrimin e bizneseve;
- Administrimin e zyrave në bashki të QKR-së, si funksion i deleguar i pushtetit qendror për pushtetin vendor;
- Nëse njësitë vendore, dëshirojnë që për t'i ardhur në ndihmë biznesit të tyre duan të hapin, me shpenzimet e tyre, një sportel të ri kjo gjë është e mundur të bëhet, por për standardin e hapjes së zyrës dhe lidhjes së saj me qendrën duhet të bashkëpunohet me QKR-në.

Me qëllim uljen e evazionit fiskal, kontrollit të kufirit të xhiros së biznesit, mbi dhe nën 8 milion lekë, xhiro vjetore, të dy nivelet e pushteteve (ai qendror dhe ai vendor), janë të detyruara ligjërisht të shkëmbejnë informacione.

Kështu, administrata tatimore vendore, është e detyruar të njoftojë institucionet qendrore, për evazionet e konstatuara në sigurimet shoqërore dhe punësim.

Administrata tatimore vendore, në raste të përcaktuara me ligj, i drejtohet për ndihmë administratës tatimore qendrore. Gjithashtu, bashkëpunimi kërkohet edhe në lidhje me administrimin e territorit dhe ushtrimin e aktivitetit të bizneseve të mëdha.

Mosmarrëveshjet në çështje që kanë të bëjnë me juridiksionin, apo me kompetencën e administratës tatimore vendore, me administratën tatimore qendrore, zgjidhen duke u mbështetur në parimin e mirëkuptimit të ndërsjelltë.

Në rastë se, palët e mësipërme nuk arrijnë në mirëkuptim, atëherë kompetente për zgjidhjen e konfliktit është gjykata, nën juridiksionin e së cilës përfshihet çështja.

Njqv-të, bashkëpunojnë me:

- Thesarin, në lidhje me njoftimin për arkëtimin e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore;
- Organet qendrore, në lidhje me asistencën teknike dhe kompjuterizimin e sistemit;
- Organet qendrore, në lidhje me decentralizimin dhe lincensimin e biznesit;
- Organet qendrore, për gjetjen e mundësive optimale, në shlyerjen e detyrimeve vendore, nga subjektet e bizneseve të mëdha (mbi 8 milion lekë xhiro/vit);

- Organet qendrore, për luftimin e kontrabandës dhe evazionit fiskal;
- Organet qendrore, për kontrollin e xhiros së biznesit të vogël, nëpërmjet kasave regjistruese dhe mbajtjes së kontabilitetit.

Decentralizimi fiskal sfide e së ardhmes

Integrimi i Shqipërisë në strukturat Euro-Atlantike, zhvillimi i reformave me prirje drejt globalizimit, përparimi i shpejtë teknologjik, ndryshimi i vlerave sociale dhe i presioneve konkurruese, po diktojnë ndryshime thelbësore social-ekonomike. Tëre këto fenomene dhe kjo dinamike, paraqesin sfida për qeverinë, pushtetin vendor dhe biznesin, prandaj është e rëndësishme që në këtë realitet, të dimë dhe të krijojmë hapësirat e nevojshme për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Reforma e decentralizimit, synon të bëjë më të qëndrueshëm sistemin demokratik, të rrisë eficiencën dhe efektivitetin qeverisës, të stimulojë krijimin e një baze më të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik dhe të bëjë qeverisjen më transparente, duke siguruar pjesëmarrjen e qytetareve në vendimmarrjen për administrimin e resurseve lokale. Kjo reformë në vendin tone, ka hedhur themelet institucionale dhe ligjore në zgjerimin e autonomisë së qarqeve, bashkive dhe komunave për shfrytëzimin e burimeve lokale, natyrore dhe njerëzore dhe investimeve private.

Decentralizimi i pushtetit dhe rritja e autonomisë së pushtetit vendor janë në lidhje të drejtë lineare me decentralizimin fiskal pra me rritjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Sfidat për pushtetin vendore dhe atë qendror është ajo e thellimit të decentralizimit fiskal. Të gjithë e dimë se financat publike nuk mbrohen duke i centralizuar përkundrazi ato janë më të mbrojtura kur decentralizohen dhe ndërtohet një kuadër ligjor eficient dhe praktik për përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë financiare dhe publike ndaj taksapaguesve.

Ndër sfidat kryesore të vitet e ardhshme do jenë:

1. Rivlerësimi dhe rishikimi i kuadrit ligjor dhe aplikativ për taksën mbi pasurinë. Kjo taksë në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim është taksë kryesore e të ardhurave për pushtetin vendor, ndërkohë që tek ne nuk e ka rëndësinë dhe peshën e duhur në të ardhurat vendore.
2. Investimet në modernizimin e mbledhjes së taksave vendore nëpërmjet programeve dhe softëve të ndryshme është një tjetër sfidë për pushtetin vendor.
3. Rritja e transparencës në lidhje me vendimmarrjet për vendosjen dhe përdorimin e taksave vendore mbetet një sfidë e rëndësishme e pushtetit vendor në çdo kohë.

4. Lidhja e politikave fiskale vendore me ato zhvillimore është një nga recetat fiskale më të dobishme për rritjen e bazës së të ardhurave dhe për një zhvillim të qëndrueshëm vendor.

